



Kolegji AAB

Nr. 553125 Prot.

Prishtinë, më 02.09 2025



Nr. 1370 Prot.

Tiranë, më 2.9 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet
Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
dhe
Kolegit AAB, Prishtinë, Kosovë

Preambulë

Në fryshtë e bashkëpunimit akademik dhe promovimit të vlerave të përbashkëta në arsimin e lartë, art, kulturë dhe zhvillim institucional, **Kolegji AAB**, me seli në Prishtinë, Republikën e Kosovës, i përfaqësuar nga **Rektori, Dr. Sc. Blerim Olluri**, dhe **Universiteti i Arteve**, me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, i përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli**, të dy së bashku, referuar si Palë/t, duke njojur rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional përmirësimin e cilësisë akademike, kërkimit shkencor, zhvillimit të artit dhe ndërlidhjes së praktikës artistike me shoqërinë, bien dakord të formalizojnë këtë marrëveshje të bashkëpunimit, me termat si më poshtë:

Neni 1: Objektivat e Marrëveshjes

- Të nxisë dhe konsolidojë marrëdhënet institucionale ndërmjet dy institacioneve në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe prodhimit artistik.
- Të krijojë platforma të përbashkëta për shkëmbimin e njohurive, praktikave dhe përvojave akademike dhe kulturore.
- Të kontribuojë në fuqizimin e rolit të institacioneve të arsimit të lartë në ndërtimin e një shoqërie demokratike, krijuese dhe të qëndrueshme.



Neni 2: Fushat e Bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke dhe të strukturuar në fushat e mëposhtme:

1. Shkëmbimi i stafit akademik dhe studentëve në procesin mësimor, praktika artistike, projekte, studime të përbashkëta dhe angazhim në aktivitete ndërkombëtare.
2. Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore, artistike dhe pedagogjike, përfshirë aplikimet për fonde në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta akademike, shkencore dhe kulturore si konferenca, simpoziume, festival, eksposita, shfaqje teatrore, masterklase dhe tryesa diskutimi.
4. Promovimi i botimeve të përbashkëta dhe përkrahja e iniciativave editoriale në fushën e arteve dhe teorisë së artit.
5. Mbështetja për zhvillimin institucional, përfshirë trajnime për stafin, këshillim akademik, vlerësimi programesh dhe projektesh të zhvillimit të kapaciteteve.

Neni 3: Zbatimi dhe Koordinimi Institucional

1. Secila Palë do të caktojë një **koordinator zyrtar** për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, i cili do të veprojë si pikë kontakti dhe ndërlidhjeje mes institucioneve.
2. Aktivitetet që rrjedhin nga kjo marrëveshje, do të rregullohen nëpërmjet **marrëveshjeve të veçanta të bashkëpunimit**, të cilat do të përcaktojnë objektivat, afatet dhe burimet e nevojshme.


Neni 4: Prezenca në Platformat Zyrtare

Në kuadër të transparencës dhe afirmimit publik të partneritetit:

1. Palët do të përfshijnë logot, emrat dhe përshkrimet përkatëse të bashkëpunimit në sektionet e dedikuara në **faqet zyrtare** të secilit institucion.
2. Gjithashtu, palët bien dakord për aktivitetet e përbashkëta të vendosin **linkun zyrtar** të partnerit në faqet e tyre përkatëse si më poshtë:
 - o <https://aab-edu.net/>
 - o www uart.edu.al

Neni 5: Kohëzgjatja, Rishikimi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet e vlefshme për një periudhë **pesë (5) vjeçare**.
2. Marrëvesha mund të **rishikohet apo zgjatet** me pëlqim të ndërsjellë me shkrim nga të dy palët në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së saj.
3. Kjo Marrëveshje mund të **zgjidhet** para përfundimit të afatit, sipas pikës 1-të këtij nen, nga secila Palë, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim drejtuar Palës tjetër të pakfën 1 (më) muaj, afat ky



me kalimin e të cilit Marrëveshja quhet e zgjidhur.

Neni 6: Rregullimi i Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me **dialog** të **mirëbesuar** mes palëve. Në rast pamundësie për marrëveshje, çështja i referohet procedurave të brendshme ligjore të secilit institucion në mënyrë të ndarë, pa paragjykuar bashkëpunimin e ardhshëm.

Neni 7: Vlerë Ligjore dhe Interpretim

Kjo marrëveshje është instrument i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe nuk krijon detyrime të natyrës financiare për asnjërën Palë, përvèç rasteve të rëna dakord me shkrim. Çdo dokumentacion shtesë (protokolle, anekse, plane pune) do të jetë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në 2 dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, të dyja me vlerë të barabartë juridike.

Për Kolegjin AAB:

Dr. Sc. Bllohim Ohuri

Rektor



Për Universitetin e Arteve:

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor

